

BIO E ANETAREVE TE KESHILLIT DREJTUES

KRISTIN L. GIANTRIS

Kristin Giantris ka mbi 25 vjet eksperiencë në fushat e zhvillimit ekonomik dhe financë. Ajo ka ngritur dhe aplikuar ekspertizën e saj në sektorin social dhe privat sikurse dhe ka drejtuar ekipe dhe projekte ndërkombëtare dhe në gjithë SHBA-në. Puna e saj në zhvillimin ekonomik është fokusuar në Evropën Qendrore dhe Lindore, veçanërisht në Shqipëri.

Znj. Giantris ka qenë Përfaqësuese për OJQ ndërkombëtare në Shqipëri dhe projekte të USAID, sikurse dhe Këshilltare e IFC për financat vendore në Ministrinë e Financave të RSH. Eksperienca e Znj. Giantris në sektorin e bankingsut privat ka qenë me Citigroup ku ajo mbulonte klientët e institucioneve financiare bankare nga Azia, Australia, Kanadaja dhe Evropa, të cilët hynin në tregun e të ardhurave fikse në SHBA. Aktualisht Znj. Giantris është Drejtuese e Lartë për Këshillimin Financiar për një Fond Financiar Jofitimprurës, ku ajo drejton krijimin dhe zbatimin e mjeteve financiare inovative dhe shërbimet këshilluese të cilat kanë ndikim social dhe financiar dhe menaxhon një ekip kombëtar.

Znj. Giantris është pjesë e disa bordeve dhe komiteteve këshilluese në SHBA dhe më gjerë. Ajo është themeluese dhe aktualisht Kryetare e Bordit për The Access Challenge, një organizatë globale për mbështetjen e shëndetit publik.. Ajo është anëtare e këshillit drejtues në Downtown Art, një organizatë e arteve dhe drejtësisë shoqërore në New York City. Për më shumë znj. Giantris është anëtare në Komitetin Këshillues të Çmimit të Kulturës së Shëndetit të Fondacionit Robert Wood Johnson, ashtu si dhe pjesë e Komisionit Value-Based Payment në NYC.

Znj. Giantris ka master në politikat publike nga Shkolla e Punëve Publike dhe Ndërkombëtare nga Universiteti i Kolumbias, një Diplomë (BA) në shkencat politike nga Kolegji Kenyon dhe ka ndjekur Fakultetin e Filozofisë në Universitetin e Zagrebit. Znj. Giantris ka lindur dhe është rritur në SHBA, me origjinë nga Korça, Shqipëri.

Kontakte per mediat:

Zyra e shtypit: mp@abi.al